

ALBANSK

BIBLIOTEKA POPULLORE - Një ofertë për të gjithë

Në bibliotek

Biblioteka është një ofertë për të gjithë.

Biblioteka është e hapur dhe është një vend takim falas për fëmijët ashtu edhe për rini dhe të rritur.

Rregullat janë të njejta për të gjithë.

Në biblioteken popullore mund të gjeni materiale nga më të ndryshmet si për shembull:

Libra, gazeta, revista, libra me kaseta, kurse në disa vende mund të gjeni edhe libra të posaçme për të mësuar gjuhë të ndryshme, libra të muzikes, internetin, video apo DVD.

Shumica e materialeve mund të mirret në shtëpi. Por sa i përket enciklopedis, gazetave dhe revistave, si zakonisht nuk mund ti merrni me vete në shtëpi por të shfrytëzoni këto në lokalet e bibliotekës.

Në biblioteken norvegjeze popullore mund të gjeni edhe libra por edhe gazeta me permbajtje të gjërë dhe të ndryshme politike dhe fetare. Oferta të gjëra dhe të gjithanëshme janë parimore për ne.

Biblioteka është pronë e bashkisë dhe paguhet nga bashkia.

Si mund të merrni libra në bibliotekë?

Të gjithë ata që banojnë në Norvegji mund të antarsohen me libereza të antaresis, duke treguar letërnjoftimin.

Fëmijet duhet të posedojnë nënshkrimin e prindërve ose të kujdestarit të tyre për të iu lëshuar një librezë e tillë.

Libreza e antaresis është dokument personal dhe nuk mund të përdoret nga të tjerët. Anëtari është ai që mban përgjegjësi për ato libra që janë regjistruar në librezë.

Kjo librezë duhet treguar sa herë që dëshironi të merrni libra në biblioteken përkatëse.

Koha e huazimit është katër javë, por për disa lloje të librave apo materiale të ndryshme mund të vendoset afate të tjera. Pyetni për këtë pran bibliotekës në rrethinën tuaj.

Huazimi është falas në bibliotekë, por në qoftë se ju e riktheni materialin e huazuar pas afatit të përcaktuar atëherë duhet të paguhet një taksë apo lloje gjobe të vogël. Njëkohësisht jeni të detyruar që të paguani dëmshpërblim për material të shkatërruar apo të humbur.

Oferta për fëmijët, të rinjët dhe të rriturit

Në bibliotekë mund të merrni romane, libra me përralla të ndryshme, libra ilustruese dhe fotografi, poezi, drama apo edhe libra me tematika të ndryshme.

Mund të lexoni gazeta, fletushka dhe revista. Apo të shfrytëzoni internetin.

Në qoftë se keni pyetje atëherë personeli do të përgjigjet në ato pyetje apo mund të përdorni enciklopedit dhe libra tjera.

Shumë biblioteka bëjnë organizime të ndryshme për fëmijë, rini dhe të rritur.

Pyetni për këtë pran bibliotekës suaj.

Libra në gjuhën shqipe

Biblioteka ka libra edhe në gjuhën shqipe.

Në ato bashki ku ka të vendosur shqiptare është e zakonshme që biblioteka të ketë libra edhe në gjuhën shqipe.

Drejtohuni personelit të bibliotekës në qoftë se nuk gjeni libra në gjuhën shqipe.

Biblioteka juaj mund të bëjë porosi për dërgimin e librave shqipe nga biblioteka shumëgjuhëshe në Oslo.

Biblioteka shumëgjuhëshe

Biblioteka shumëgjuhëshe është një bibliotekë e veçant për literatur në gjuhët e ndryshme të minoriteteve.

Biblioteka nuk është publike.

Librat nga biblioteka shumëgjuhëshe mund ti porosisni nëpërmes bibliotekës tuaj në rrethinën ku jetoni. Ata mund të ua plotsojnë edhe dëshirat tuaja sa i përket ndonjë libre apo materiali të veçant.

Katalogu i librave

Biblioteka shumëgjuhëshe përpilon lista apo katalogje të librave të cilat i posedojn në shumë gjuhë.

Listat apo ato katalogje me libra të reja gjenden edhe në internet adresën e Deichmanske - bibliotekës popullore (DFB) : www.dfb.deichman.no

Drejtohuni personelit të bibliotekës suaj për këso listash apo katalogjesh.

Si mund të shfrytëzoni bibliotekën ? Ta ruash gjuhën tënde amtare !

Duke lexuar libra në gjuhën amtare mund të ruani gjuhën tuaj amtare. Njëkohësisht kjo vlen edhe për fëmijet tuaj. Nëpërmes leximit mund ti mësoni që ata të përvetsojnë gjuhën. Është shumë me rëndësi që të mirëmbajm gjuhën amtare.

Të mësosh gjuhën norvegjeze

Për të përballuar në shoqërin norvegjeze është më se e nevojshme që të dimë gjuhën zyrtare (norvegjishten). Duke marrë libra për gjuhë, leximi i librave tjera dhe dëgjimi i librave me kaseta të shpie deri në mësimin e gjuhës norvegjeze.

Të nxjerrish njohuri

Është me rëndësi të keni vetëm njohuri të duhura. E pastaj në bibliotekë mund të gjeshtë shumë informata si për shembull mbi:

- shoqërin norvegjeze
- vendlindjen tuaj
- të drejtat tuaja
- detyrimet tuaja
- si dhe shumë gjëra me tematika të ndryshme.....

Biblioteka popullore në rrethinën tuaj gjendet:

FREDRIKSTAD BIBLIOTEK

J.N. Jacobsensgt. 1

1601 Fredrikstad

Tlf. 69 38 34 00

www.fredrikstad.kommune.no/biblioteket

Shfrytëzoni bibliotekën !